



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla ZRRE/Nr. 13/2017

**Rregulla për Vlerësimin e Projekteve Kapitale në Rrjetin e Transmetimit dhe
Shpërndarjes në Sektorin e Energjisë Elektrike**

Maj 2017

Përmbajtja

KREU I	DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	3
Neni 1	Fushëveprimi dhe qëllimi	3
Neni 2	Përkufizimet dhe interpretimet.....	3
KREU II	DORËZIMI I PLANEVE TË PROPOZUARA PËR INVESTIME	4
Neni 3	Orari i dorëzimit dhe rishikimit	4
Neni 4	Përmbajtja e Planit Pesëvjeçar Investues.....	5
Neni 5	Vlerësimi dhe Aplikimi.....	6
KREU III	REZULTATET E PËRCAKTUARA.....	7
Neni 6	Përcaktimi i Rezultateve	7
Neni 7	Raportimi i Performancës.....	8
KREU IV	ANALIZA E KOST-BENEFITIT TË PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE	8
Neni 8	Qëllimi dhe Qasja në AKB	8
Neni 9	Vlerësimi i Kostove dhe Përfitimeve	9
Neni 10	Kriteret dhe Vlerat Hyrëse.....	10
KREU V	PRIORITIZIMI I PROJEKTIT	11
Neni 11	Faktorët e prioritizimit	11
KREU VII	DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE.....	13
Neni 12	Interpretimi	13
Neni 13	Ndryshimi	13
Neni 14	Hyrja në fuqi	13

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-84, nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 dhe nenin 26, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nënparagrafi 1.2, në seancën e mbajtur me 10.05.2017, miratoi:

Rregulla për Vlerësimin e Projekteve Kapitale në Rrjetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes në Sektorin e Energjisë Elektrike

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi dhe qëllimi

1. Kjo Rregull përcakton:
 - 1.1 Procesin e dorëzimit nga të licencuarit si: Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Tregut dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të planeve të tyre të propozuara për investime, kostot e të cilave duhet të mbulohen nga tarifat e rregulluara, si pjesë e çdo Shqyrtimi Tarifor Shumëvjeçar;
 - 1.2 Të dhënat, dëshmitë dhe arsyetimet që duhet të dorëzohen nga të licencuarit e lartpërmendur për të mbështetur planet e tyre të propozuara për investime;
 - 1.3 Vlerësimin nga Rregullatori për arsyeshmërinë e planeve investive para aprovimit të tyre në kuadër të Shqyrtimit Periodik.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimet

1. Shprehjet e mëposhtme në këtë Rregull kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1 **Plani Dhjetë Vjeçar i Zhvillimit të Rrjetit ose 10YNDP** - planifikimi dhjetë vjeçar (10) i nevojave për investime në kapacitetet e transmetimit apo shpërndarjes me synim të plotësimin të kërkesave të sistemit për energji elektrike dhe sigurimin e furnizimit të konsumatorëve, i cili aprovohet nga Rregullatori;
 - 1.2 **Plani Pesëvjeçar Investues (SYNIP)** - zhvillimi i planit pesë (5) vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit apo shpërndarjes brenda vitit aktual për periudhën pesë (5) vjeçare që duhet të jetë në harmoni me planin dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit apo shpërndarjes, me dokumentacionin e planifikimit hapësinor dhe me planin pesë (5) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, i cili duhet të aprovohet nga Rregullatori;
 - 1.3 **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose OSSH** - personi fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe

për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike;

- 1.4 **Operatori i Sistemit të Transmetimit ose OST** - personi fizik, ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar përfshirë kurdo që kjo është e mundur, interkonektorët me sistemet tjera, dhe për të garantuar aftësinë afatgjate të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike;
 - 1.5 **Analiza Kost-Benefit ose AKB** – procesi i përcaktimit të kostove dhe përfitimeve nga një projekt gjatë një periudhe të caktuar dhe alternativave të tij brenda të njejtës periudhë në mënyrë që të ketë shkallë të arsyeshme të krahasimit për një vlerësim të drejtë;
 - 1.6 **Rrjeti European i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike ose ENTSO-E**;
 - 1.7 **Periudha Rregullative** - Përcaktimi i të hyrave të lejuara maksimale për periudhën rregullative që përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike;
 - 1.8 **Vlera Neto e Tanishme ose NPV**;
 - 1.9 **Vlera e Ngarkesës së Humbur ose VNH** - Vlerësimi i gatishmërisë së konsumatorëve për të paguar kosto shtesë për të përmirësuar cilësinë e furnizimit;
 - 1.10 **Zyra e Rregullatorit për Energji** - është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
2. Termat e tjera të kësaj rregulle do ta kenë kuptimin që u është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike apo në Ligjin për Energjinë.

KREU II

DORËZIMI I PLANEVE TË PROPOZUARA PËR INVESTIME

Neni 3

Orari i dorëzimit dhe rishikimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes duhet të dorëzojë te Rregullatori një Plan Preliminar Pesëvjeçar për Investime në Rrjet (5YNIP) jo më vonë se 15 marsi i vitit që i paraprin Shqyrtimin Periodik. Përmbajtjet e Planit Pesëvjeçar Investues janë specifikuar në Nenin 4.
2. Deri më 5 maji të të njëjtit vit, Rregullatori do të identifikojë informatat apo të dhënat shtesë te nevojshme për të kompletuar shqyrtimin e Planit Pesëvjeçar Investues preliminar.
3. Deri më 1 qershor të të njëjtit vit, të licencuarit (OST/OT dhe OSSH) do të dorëzojnë te Rregullatori Planin Pesëvjeçar sipas përmbajtjes së specifikuar në Nenin 4 dhe do të marrin parasysh informatat apo të dhënat shtesë të kërkuara nga Rregullatori pas shqyrtimit preliminar.

4. Një përmbledhje e Planit Pesëvjeçar Investues do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit. Informatat konfidenciale mund të redaktohen në përmbledhjen e publikuar.
5. Deri më 15 gusht të të njëjtit vit, Rregullatori do të identifikoj çdo informatë shtesë apo të dhënë që kërkohet për përfundimin e shqyrtimit të vetë të Planit Pesëvjeçar Investues të dorëzuar. Të licencuarit duhet të dorëzojnë çdo informatë ose të dhënë të tillë shtesë të identifikuar deri më 31 gusht të të njëjtit vit.
6. Rregullatori mund të kërkojë të licencuarve të prezantojnë Planin Pesëvjeçar Investues në një seancë publike si pjesë e procesit të vlerësimit.

Neni 4

Përmbajtja e Planit Pesëvjeçar Investues

1. Plani Pesëvjeçar Investues që do të dorëzohet të Rregullatori duhet të jetë në harmoni me Planin Zhvillimor Dhjetëvjeçar dhe duhet të përmbajë, së paku, përmbajtjet e mëposhtme:
 - 1.1 Një shpjegim për procesin e përdorur për përgatitjen e Planit Pesëvjeçar Investues dhe procesin e identifikimit dhe përfshirjes së kërkesave të shfrytëzuesve të rrjetit në plan;
 - 1.2 Një përmbledhje të Planit Pesëvjeçar Investues që tregon shpenzimet e pritshme dhe vlerat e komisionimit të asetëve në çdo vit të periudhës rregullative;
 - 1.3 Një grup i rezultateve të përcaktuara të cilat do të arrihen nga Planit Pesëvjeçar Investues, kundrejt të cilave do të vlerësohet performanca e të licencuarit;
 - 1.4 Një listë e të gjitha projekteve të mëdha individuale që do të ndërmerren në kuadër të Planit Pesëvjeçar Investues, e shoqëruar me një përmbledhje të përshkrimit teknik, vlerësime të kostos, plan të zbatimit dhe arsyetim për nevojën e projektit duke përfshirë shtjellimin e alternativave që janë marrë parasysh;
 - 1.5 Një listë e grupimeve të projekteve të vogla që do të ndërmerren në kuadër të Planit Pesëvjeçar Investues, të shoqëruar me një përmbledhje të përshkrimit teknik, vlerësime të kostos, plan të zbatimit, arsyetim teknik;
 - 1.6 Në rastet kur një projekt ose grup i projekteve të vogla tejkalon pragun e përcaktuar, një analizë ekonomike të kost-benefitit (AKB) për atë projekt ose program duhet të dërgohet tek Rregullatori;
 - 1.7 Në rast se ka dallim ndërmjet Planit Pesëvjeçar Investues dhe Planit Dhjetëvjeçar të Zhvillimit të Rrjetit (10YNDP) të fundit të miratuar, i licencuari duhet të përfshijë arsyeshmërinë e dallimeve eventuale;
 - 1.8 Një renditje prioritare të projekteve dhe grupeve të projekteve të vogla të përfshira në Planin Pesëvjeçar Investues;
 - 1.9 Një përshkrim të rreziqeve kryesore në arritjen e Planit Pesëvjeçar Investues dhe mënyrën se si i licencuari ka për qëllim që të zbusë ose të menaxhojë ato.

2. Të gjitha projektet dhe grupet e projekteve të vogla që do të përfshihen në Planin Pesëvjeçar Investues duhet të kenë të përfunduar një studim të para-fizibilitetit dhe fizibilitetit. Këto studime mund të përjashtohen vetëm pas dërgimit të kërkesës me arsyeshmeri nga i licencuari dhe aprovimit të saj nga Rregullatori.
3. Për qëllime të paragrafit 1.5 të këtij neni, një projekt 'i madh' në sistem të transmetimit duhet të përkufizohet si një projekt me një kosto të vlerësuar kapitale të barabartë me ose më të madhe se 300,000 € ose një kufizim të tillë tjetër për të cilin Rregullatori mund të njoftoj kohë pas kohe të licencuarit.
4. Për qëllime të paragrafit 1.5 të këtij neni, një projekt 'i madh' në sistem të shpërdarjes duhet të përkufizohet si një projekt me një kosto të vlerësuar kapitale të barabartë me ose më të madhe se 100,000 € ose një kufizim të tillë tjetër për të cilin Rregullatori mund të njoftoj kohë pas kohe të licencuarit.
5. Për qëllime të paragrafit 1.7 të këtij neni, pragu për një projekt ose program individual të projekteve të shumta për të cilat duhet të bëhet analiza kosto-benefit duhet të jetë mbi 1 milion €. Rregullatori mund të kërkojë nga i licencuari analizën e kost benefitit edhe për projekte ose për grupe të projekteve të vogla nën vlerën 1 milion €.

Neni 5

Vlerësimi dhe Aplikimi

1. Rregullatori do të publikoj raportin e vetë të vlerësimit për secilën Plan Pesëvjeçar Investues 5YNIP jo më vonë se me datë 30 shtator të të njëjtit vit, i cili do të identifikojë se:
 - 1.1 cilat projekte dhe grupet e projekteve të vogla Rregullatori propozon të përfshihen në të hyrat e lejuara që do të mbulohen gjatë periudhës së ardhshme rregullative dhe nivelin e shpenzimeve për vit;
 - 1.2 cilat projekte dhe grupet e projekteve të vogla nuk do të përfshihen në të hyrat e lejuara dhe cilat do të përfshihen me një kosto tjetër kapitale nga ajo që është përfshirë në Planin Pesëvjeçar Investues të dorëzuar me një shpjegim të arsyeve për secilin rast.
2. Përderisa raporti i vlerësimit do të jetë një kontribut për llogaritjen e të hyrave të lejuara që do të mbulohen në kuadër të periudhës rregullative të ardhshme, kjo nuk do të detyrojë Rregullatorin që të përfshijë ose përjashtoj ndonjë projekt ose program individual nga këto të hyra të lejuara ose koston kapitale të bashkangjitur në ndonjë projekt ose program individual të përfshirë.
3. Plani final i investimeve do të përcaktohet si pjesë e vendimit final të Shqyrtimit të Tarifave për Periudhë Rregullative pas procesit të konsultimit publik dhe analizës së të hyrave të lejuara që janë propozuar dhe do të publikohen në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit së bashku me atë vendim.
4. Pas publikimit të planit final të investimeve, nga të licencuarit pritet që të zbatojnë këtë në mënyrë të plotë përveç në rastet, kur gjatë periudhës rregullative, projektet ose programet individuale

identifikohen se më nuk janë të nevojshme ose mund të zëvendësohen me alternativa që ofrojnë rezultate ekuivalente me një kosto më të ulët për jetëgjatësinë e tyre.

5. Të licencuarit do të raportojnë në baza vjetore në Rregullator rreth progresit në zbatimin e planit të investimeve, duke identifikuar çdo vonesë ose devijim nga plani dhe duke shpjeguar arsyet për to.
6. Të licencuarit gjithashtu do të raportojnë në baza vjetore për shpenzimet e përgjithshme kapitale sipas projektit ose programit individual dhe në total kundrejt atyre në planin final të investimeve, duke identifikuar dhe shpjeguar çdo mospërputhje në mes të planit dhe vlerave aktuale.
7. Rregullatori do të marrë parasysh këtë performancë kundrejt planit final të investimeve kur të kryen shqyrtimin e vetë të Planit Pesëvjeçar Investues dhe të hyrave të lejuara gjatë periudhës së ardhshme të rregullative.

KREU III REZULTATET E PËRCAKTUARA

Neni 6

Përcaktimi i Rezultateve

1. Si pjesë e 5YNIP të dorëzuar, i licencuari do të dorëzojë një sërë rezultatesh të propozuara për monitorimin e arritjes së përfitimeve të pritshme nga plani i investimeve.
2. Këto rezultate duhet të kenë përcaktim sasior dhe të jenë të verifikueshme nga të dhënat e publikuara ose nga të dhënat e mbledhura nga i licencuari.
3. Rezultatet duhet të përfshijnë masat e besueshmërisë, sigurisë dhe cilësisë së rrjetit të të licencuarit si dhe rezultate të tilla që mund të konsiderohen si të përshtatshme. Në minimum, rezultatet duhet të përfshijnë:
 - 3.1 Frekuencën dhe kohëzgjatjen e defekteve në rrjet;
 - 3.2 Energjinë që nuk është shërbyer si rezultat i mungesës së rrjetit të të licencuarit;
 - 3.3 Nivelin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjet;
 - 3.4 Gjendja e asetëve të rrjetit.
4. Për secilin rezultat, i licencuari duhet të definojë në Planin Pesëvjeçar Investues të dorëzuar:
 - 4.1 Një vlerë bazë, që përfaqëson performancën aktuale;
 - 4.2 Vlerën e synuar në përfundim të periudhës së ardhshme rregullative nëse zbatohet Plani Pesëvjeçar Investues i dorëzuar;

- 4.3 Vlerën e parashikuar në përfundim të periudhës së ardhshme rregullative nëse nuk zbatohet Plani Pesëvjeçar Investues i dorëzuar;
- 4.4 Një shpjegim se si janë nxjerrë këto synime dhe vlera të parashikuara;
- 4.5 Një përshkrim se si mund të matet dhe verifikohet performanca për secilin rezultat.

Neni 7

Raportimi i Performancës

1. Para përfundimit të secilës periudhë rregullative, i licencuari duhet të raportojë mbi performancën aktuale kundrejt secilit rezultat në raport me atë të projektuar në Planin Pesëvjeçar Investues.
2. ZRRE-ja do të marrë parasysh dallimet në mes të performancës aktuale dhe performancës së parashikuar në dhënien e rezultateve në:
 - 2.1 Vlerësimin e arsyeshmërisë, arsyetimin dhe rreziqet që lidhen me projektet dhe programet e propozuara të përfshira në Planin Pesëvjeçar Investues të dorëzuar në periudhën e ardhshme;
 - 2.2 Përcaktimin nëse do të aplikohet ndonjë kthim i kostove ose ndryshim tjetër në të hyrat e lejuara në kuadër të periudhës së ardhshme për shkak të ndonjë dështimi për të përfunduar programin e miratuar të investimeve për periudhën aktuale.

KREU IV ANALIZA E KOST-BENEFITIT TË PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE

Neni 8

Qëllimi dhe Qasja në AKB

1. Në këtë Kapitull, shprehja 'projekt' përdoret për t'iu referuar edhe projekteve të mëdha individuale dhe programeve të shumëfishta të projekteve të vogla për të cilat aplikohet AKB.
2. Qëllimi i AKB është që të tregojë se:
 - 2.1 Për projektet diskrecionare, të përcaktuara si ato që nuk ndërmerren për të përmbushur obligimet ligjore, projekti i propozuar ka neto përfitim pozitiv shoqëror dhe se ofron neto përfitimin me të madh pozitiv shoqëror nga cilado alternativ e marrë parasysh;
 - 2.2 Për projektet e detyrueshme, të përcaktuara si ato që ndërmerren për të përmbushur obligimet ligjore, projekti i propozuar ka koston më të ulët nga alternativat e marra parasysh.
3. Obligimet ligjore të referuara në paragrafin 2 janë kërkesat ligjore për të përmbushur standardet ose obligimet specifike mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë të vendosura në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Kosova është palë nënshkruese.

4. Projektet e ndërmarra për të përmbushur detyrimet për lidhje dhe/ose shfrytëzim të projekteve të përcaktuara të energjisë së ripërtëritshme në përputhje me kërkesat ligjore dhe politikat e Qeverisë së Kosovës duhet të konsiderohen si projekte të detyrueshme për qëllimet e paragrafit 2 më lartë.
5. ZRRE-ja mundet, kur të shqyrtoj Planin Pesëvjeçar Investues të dorëzuar, të përcaktoj që projektet e propozuara për të cilat është ofruar një AKB, të riklasifikohen nga ato diskrecionare në të detyrueshme ose anasjelltas dhe që AKB të rillogaritet në përputhje me rrethanat dhe të dorëzohet përsëri.
6. Për projektet diskrecionare, AKB krahason vlerën aktuale neto (NPV) të përfitimeve shoqërore të projektit pa koston totale të projektit nga alternativat e identifikuar.
7. Për projektet e detyrueshme, AKB krahason vlerën aktuale të koston totale të projektit nga alternativat e identifikuar.
8. Analiza e duhur e ndjeshmërisë duhet të përfshihet, duke treguar së paku ndikimin e ndryshimeve nga projeksionet bazë në:
 - 8.1 Parashikimet e kërkesës dhe shfrytëzimit të projektit;
 - 8.2 Kontributin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
 - 8.3 Datën e komisionimit të projektit.
9. Kur ndonjë aspekt i këtyre udhëzimeve në lidhje me AKB është i paqartë ose jo i plotë, i licencuari duhet t'i referohet *ENTSO-E Udhëzime për Analizën e Kost-Benefitit të Projekteve të Zhvillimit të Rrjetit*.

Neni 9

Vlerësimi i Kostove dhe Përfitimeve

1. Kostot totale të projektit, ashtu siç përdoren në AKB, përfshijnë:
 - 1.1 Investimet kapitale që kërkohen duke përfshirë interesin gjatë ndërtimit dhe kosto tjera financiare dhe duke përjashtuar taksat;
 - 1.2 Një lejim i duhur për kontigjenca fizike dhe të çmimeve;
 - 1.3 Kostot e parashikuara të operimit dhe mirëmbajtjes gjatë periudhës më të shkurtër të projektit ose periudhës vlerësuese duke përfshirë çdo kosto rehabilitimi ose riparimi kapital;
 - 1.4 Ndonjë ndikim negativ të matshëm mjedisor ose social që rezulton nga projekti, i vlerësuar me gatishmërinë e banorëve të Kosovës që të paguajnë për të shmangur kosto të tilla.
2. Përfitimet totale të projektit, ashtu siç përdoren në AKB, përfshijnë:

- 2.1 Çdo reduktim në investime kapitale dhe/ose kosto të operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes që rezultojnë nga projekti;
 - 2.2 Çdo reduktim në humbjet e sistemit që rezulton nga projekti, i vlerësuar me koston e parashikuar të blerjes së energjisë me shumicë;
 - 2.3 Çdo reduktim në Neto Energjinë e Shërbyer të parashikuar që rezulton nga projekti, i vlerësuar me Vlerën e Ngarkesës së Humbur (VNH) të aprovuar;
 - 2.4 Çdo reduktim në kosto të energjisë elektrike të furnizuar tek konsumatorët e energjisë elektrike që ndodhen brenda territorit të Kosovës që rezulton nga kufizimet e reduktuara të sistemit ose integrim më të madh të tregut, vlerësuar me kursimin e koston që ka rezultuar;
 - 2.5 Çdo reduktim në kostot e prokurimit ose sigurimit të shërbimeve ndihmëse;
 - 2.6 Çdo përfitim i matshëm pozitiv mjedisor ose social, i cili është i ndryshëm nga reduktimet në Emetimet e Gazrave Serë, që rezultojnë nga projekti, i vlerësuar me gatishmërinë e banorëve të Kosovës për të paguar për përfitime të tilla;
 - 2.7 Çdo reduktim në Emetimet e Gazrave Serë që rezulton nga projekti, i vlerësuar me koston sociale të karbonit ashtu siç është e përcaktuar më poshtë;
 - 2.8 Çdo përfitim tjetër i identifikuar nga i licencuari, se bashku me arsyetimin për përfshirjen e tyre;
 - 2.9 Për alternativat e projektit me $NPV < 0$, ZRRE-ja do të vendosë për nevojën e saj teknike bazuar në kriteret teknike nga Neni 6. Në rast të nevojës së projektit(eve), projekti(et) me NPV më të ulët negative do të zgjidhen si më të përshtatshmet.
3. Llogaritjet duhet të bëhen në kushte reale duke përdorur çmimet për vitin në të cilin është dorëzuar Plani Pesëvjeçar Investues (p.sh., inflacioni nuk do të merret parasysh).
 4. [Një format që do të përdoret për llogaritjen e AKB është dhënë në Shtojcën A të kësaj Rregulle.]

Neni 10

Kriteret dhe Vlerat Hyrëse

1. ZRRE-ja do të përcaktojë kriteret dhe vlerat hyrëse të mëposhtme jo më vonë se 31 dhjetori i çdo viti.
 - 1.1 Norma e zbritjes (e përdorur për llogaritjen e NPV);
 - 1.2 Periudha për vlerësim;
 - 1.3 Vlera e Ngarkesës së Humbur;
2. Kur asnjë vlerë nuk është e përcaktuar, atëherë vlejné vlerat më të fundit të përcaktuara.

3. Kur Rregulatori më parë nuk ka përcaktuar vlerën, atëherë do të zbatohen vlerat e mëposhtme:
 - 3.1 Norma e zbritjes: Vlera më e fundit e publikuar që do të përdoret për vlerësimin ekonomik nga Qeveria e Kosovës. Atëherë kur nuk është publikuar asnjë vlerë, vlera e aplikuar nga ENTSO-E në Udhëzime për Analizën e Kost-Benefitit të Projekteve të Zhvillimit të Rrjetit do të përdoret;
 - 3.2 Periudha për vlerësim: nga viti në të cilin Plani Pesëvjeçar Investues është dorëzuar deri në 10 vjet pas datës së planifikuar të komisionimit të projektit;
 - 3.3 Vlera e Ngarkesës së Reduktuar: Vlerësimet e publikuara për vendet tjera të Komunitetit të Energjisë, me një preferencë në vendet të cilat janë më së afërmi gjeografikisht me Kosovën.

KREU V PRIORITIZIMI I PROJEKTIT

Neni 11

Faktorët e prioritizimit

1. Të licencuarit duhet të përfshijnë në Planin Pesëvjeçar Investues një renditje prioritare të projekteve dhe programeve, me qëllim që të ndihmojë Rregulatorin në përzgjedhjen e atyre që do të përfshihen në programin e investimeve në periudhën rregulative.
2. Të gjitha projektet dhe programet e detyrueshme, të përcaktuara duke përdorur kriteret e përcaktuara në Nenin 8 më lartë renditen me prioritet të lartë.
3. Projektet dhe programet tjera duhet të klasifikohen si një nga:
 - 3.1 Prioritet i lartë - thelbësor;
 - 3.2 Prioritet mesatar - shumë i dëshirueshëm;
 - 3.3 Prioritet i ulët - i dëshirueshëm.
4. Klasifikimi duhet të bazohet në:
 - 4.1 Domosdoshmërinë teknike të projektit ose programit, me projektet dhe programet me arsytim më të lartë teknik që janë caktuar me prioritet më të lartë;
 - 4.2 Neto përfitimi i projektit ose programit ashtu siç është llogaritur nga AKB (atëherë kur është e aplikueshme), me projektet dhe programet me neto përfitim më të lartë që janë caktuar me prioritet më të lartë;
 - 4.3 Niveli i rreziqeve që lidhen me zbatimin e projektit ose programit, me projekte dhe programe me rreziqe të ulëta që janë caktuar me prioritet më të lartë;
 - 4.4 Faktorë tjerë të tillë që i licencuari i konsideron si relevante.

5. Renditja prioritare përfundimtare do të jetë mesatarja e ponderuar e rëndësisë së renditjes kundrejt çdo kriteri individual, përveç projekteve të domosdoshme për siguri të furnizimit me energji elektrike.
6. I licencuari duhet të përfshijë në Planin Pesëvjeçar Investues të dorëzuar një përshkrim të kriterëve të përdorura për renditjen prioritare, si është caktuar një prioritet për secilin projekt dhe program kundrejt secilit kriter, si janë përdorur peshimet për të përcaktuar renditjen prioritare përfundimtare dhe duhet të tregoj renditjen përfundimtare dhe renditjen kundrejt çdo kriteri individual për secilin projekt dhe program.

KREU VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 12
Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 13
Ndryshimi

- 1 ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
- 2 Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.


Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.

Bordi i Rregullatorit:



Krenar Bujupi, u.d. kryesues



Arsim Janova, anëtar



Besim Sejfiqaj, anëtar